



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 43

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 29 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 12, datë 27.2.2018	Për organizimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar 2579
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 13, datë 8.3.2018	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017-2018..... 2587
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 14, datë 26.3.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 23.2.2018, “Për datat dhe organizimin e provimeve të maturës shtetërore 2018” 2588
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetases Lumturi Boka..... 2588



UDHËZIM

Nr. 12, datë 27.2.2018

**PËR ORGANIZIMIN E TESTIMIT
TË INFORMATIZUAR TË
KANDIDATËVE PËR T’U PUNËSUAR
NË INSTITUCIONET ARSIMORE
PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Organizimi i testimit të informatizuar

Organizimi i testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar zhvillohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përkrahura në këtë udhëzim.

Neni 2

Qendra e testimit dhe afatet e zhvillimit të testimit të informatizuar

Testimi i informatizuar i kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar zhvillohet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, e cila publikon kalendarin e zhvillimit të testimit.

Neni 3

Drejtimi, administrimi dhe monitorimi i testimit të informatizuar

Drejtorja e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MASR drejton, administron dhe monitoron procesin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar. Drejtorja bashkëpunon me institucionet në varësi të MASR-së dhe me njësitë arsimore vendore.

Neni 4

E drejta e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar

Në testimin e informatizuar të kandidatëve për t’u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar kanë të drejtë të marrin pjesë individët që janë pranuar në fazën e parë të konkurrimit nëpërmjet vlerësimit të dosjes, fazë e cila zhvillohet në çdo njësi arsimore vendore, sipas udhëzimit përkatës të MASR-së.

Neni 5

Aplikimi për pjesëmarrje në testimin e informatizuar

Kandidati pajiset nga njësi arsimore vendore me formularin e pranimit për fazën e dytë të konkurrimit. Kandidati regjistrohet *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe plotëson çdo rubrikë të detyrueshme të portalit, me qëllim pjesëmarrjen në testim.

Neni 6

Vlerat udhëheqëse dhe parimet e procesit

Procesi i testimit udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe meritës së kandidatëve, si më poshtë janë:

- a) ruajtja e fshehtësisë së fondit të pyetjeve;
- b) korrektësia e kandidatëve në mjedisin e testimit;
- c) korrektësia e administrimit;
- d) vlerësimi i standardizuar.

KREU II

**DETYRAT DHE KOMPETENCAT E
INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE DHE
NJËSIVE ARSIMORE VENDORE**

Neni 7

**Detyrat dhe kompetencat e Qendrës
Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik
Shqiptar**

Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar është përgjegjëse për:

- a) organizimin e aplikimit të kandidatëve *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë”;
- b) njoftimin e njërive arsimore vendore për mënyrën dhe afatet e aplikimit *online*;



c) vënie në dispozicion, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, të funksionaliteteve për hartimin dhe shkarkimin e listave përfundimtare të pjesëmarrësve në testim për çdo njësi arsimore vendore;

d) vënie në dispozicion, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, të funksionit të automatizuar për mbledhjen e pikëve të përfuara në fazën e parë të vlerësimit (sipas dosjes së dorëzuar në njësitë arsimore vendore) dhe në fazën e dytë të vlerësimit (sipas rezultatit të testimit të informatizuar në QSHA), pas marrjes në dorëzim të listave me pikët e testimit të kandidatëve nga QSHA-ja;

e) vënie në dispozicion, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, të funksionit për shpalljen në portal të rezultateve përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve dhe dërgimin e tyre zyrtarisht në njësitë arsimore vendore.

Neni 8

Detyrat dhe kompetencat e Institutit të Zhvillimit të Arsimit

Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) ka detyrat e mëposhtme:

a) harton dhe publikon në faqen zyrtare të saj programet orientuese të testimit sipas profileve përkatëse, të cilat përmbajnë njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë kandidati, si dhe referencat e literaturës;

b) cakton hartuesit e fondit të pyetjeve me alternativa, që do të përdoret për çdo testim sipas profilin përkatës;

c) merr në dorëzim zyrtarisht me procesverbal fondin e pyetjeve me alternativa të çdo profili, ku do të zhvillohet testimi, nga hartuesit e fondit të pyetjeve;

d) organizon fondin e pyetjeve nëpërmjet koordinаторit të profilin përkatës, i cili vlerëson dhe miraton saktësimin e përmbajtjes së fondit të pyetjeve sipas kriterëve të përcaktuara nga QSHA-ja;

e) dorëzon zyrtarisht me procesverbal në QSHA fondin përfundimtar të pyetjeve me alternativa të miratuar për çdo profil, në format elektronik, versioni *Word*, dhe në version të printuar;

f) përcakton dhe publikon në faqen zyrtare informacionin për strukturën përmbajtësore të testit;

g) dorëzon zyrtarisht në QSHA strukturën e testit për çdo profil testimi.

Neni 9

Detyrat dhe kompetencat e Qendrës së Shërbimeve Arsimore

1. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) është përgjegjëse për zhvillimin e testimit të informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar. QSHA-ja zbaton procedurat për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale.

2. QSHA-ja, lidhur me zhvillimin e testimit të informatizuar, kryen detyrat e mëposhtme:

a) merr në dorëzim fondin e pyetjeve për çdo profil testimi të miratuar nga IZHA;

b) merr në dorëzim strukturat e testit për çdo profil testimi që do të zhvillohet për kandidatët për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar;

c) digjitalizon fondin e pyetjeve për çdo profil testimi të informatizuar;

d) harton kalendarin e organizimit të testimit të informatizuar sipas profileve të miratuara nga MASR-ja, pas marrjes në dorëzim të listave të kandidatëve nga Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar;

e) publikon listat e kandidatëve sipas profilin, datës dhe orarit të caktuar për zhvillimin e testimit në portalin “Mësues për Shqipërinë”;

f) verifikon identitetin dhe dokumentet përkatëse të kandidatëve pjesëmarrës në testimin e informatizuar;

g) siguron kushte të përshtatshme në sallat e përcaktuara për zhvillimin e testimit të informatizuar përmes teknologjisë digjitale;

h) siguron kushte të përshtatshme për kandidatët me aftësi të kufizuara fizike;

i) merr masa për gjenerimin e tezës sipas strukturës së testimit të informatizuar të bërë nga IZHA;

j) mban procesverbale për çdo vendimmarrje gjatë procedurave të zhvillimit të testimit të informatizuar, deri në shpalljen e rezultateve;

k) dërgon në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar dhe në MASR rezultatet e testimit të informatizuar;



l) harton raportin statistikor lidhur me rezultatet e testimit të informatizuar dhe ia paraqet ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

m) shqyrton ankimet për testimin e informatizuar të kandidatëve për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda tri ditëve nga shpallja e rezultatit.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive arsimore vendore

Njësia arsimore vendore:

a) pranon dosjet me dokumente të kandidatëve dhe ia kalon për shqyrtim Komisionit të Vlerësimit sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës të MASR-së;

b) plotëson formularin e pranimit në portal të kandidatit për pjesëmarrje në testimin “Mësues për Shqipërinë”;

c) përgatit listën e kandidatëve që janë kualifikuar në fazën e parë të konkurrimit dhe që do të marrin pjesë në testim, bashkë me pikët e përfutura dhe e dërgon në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar dhe në MASR;

d) përgatit listën e kandidatëve që dëshirojnë të mbartin pikët e testeve të viteve të kaluara dhe e dërgon në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar dhe në MASR, bashkë me pikët e përfutura;

e) njofton kandidatët që të aplikojnë *online* në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të MASR-së;

f) njofton secilin kandidat për vlerësimin që ka marrë.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatëve pjesëmarrës në testimin e informatizuar

1. Testimi i informatizuar zhvillohet sipas kalendarit të hartuar nga QSHA-ja, në bazë të mundësisë së sigurimit të ambienteve të testimit.

2. Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidatët duhet të kenë parasysht rregullat e mëposhtme:

a) të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë);

b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;

c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin celularë dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter përjashtimi;

d) të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e testimit;

e) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit.

3. Sallat ku do të zhvillohet testimi, mbikëqyren nga një ose më shumë administratorë nga MASR-ja, të cilët janë përgjegjës për mbarrëvajtjen e testimit sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

Neni 12

Detyrat e kandidatëve gjatë testimit të informatizuar

1. Nëse një kandidat nuk paraqitet në testim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë testimi nuk vlerësohet si i kryer.

2. Tërheqja nga testimi i informatizuar nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e testimit.

3. Në rast se kandidati do të tërhiqet nga testimi i informatizuar pas fillimit të testimit, në përfundim të testimit duhet të nënshkruajë deklaratën me rezultatin e marrë.

4. Kandidati që del nga salla e testimit, nuk do të rihyjë në sallë gjatë zhvillimit të testimit.

Neni 13

Formati i listës së kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit të informatizuar

Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar dërgon zyrtarisht dhe në format elektronik në QSHA dhe në MASR listën e kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit të informatizuar 1 (një) javë para fillimit të sesionit të zhvillimit të testeve. Lista e kandidatëve duhet të përmbajë këto të dhëna:

emër, atësi, mbiemër, ID, profili, njësia arsimore vendore.

Neni 14

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

1. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nëpërmjet dy fazave:

a) faza e parë: vlerësimi i përfutur nga dokumentet e dosjes së kandidatit sipas rezultateve të dërguara nga njësia arsimore



vendore në Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, në bazë të udhëzimit përkatës të MASR-së;

b) faza e dytë: vlerësimi i përfutur nga testimi i informatizuar (në masën 70 pikë).

2. Teza e testimit të informatizuar përmban 50 pyetje, përgjigjet e sakta të të cilave vlerësohen me 100 për qind, që konvertohet maksimalisht në 70 pikë, sipas tabelës bashkëlidhur.

3. QSHA-ja bën konvertimin e vlerësimit të testimit të informatizuar dhe ua dërgon MASR-së, njësisë arsimore vendore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

4. Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar bën mbledhjen e pikëve të të dyja fazave dhe shpalljen në portal të rezultateve përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve.

KREU III ORGANIZIMI I TESTIMIT TË INFORMATIZUAR

Neni 15

Programet orientuese

1. Programet orientuese hartohen nga IZHA mbi bazën e kurikulës së arsimit parauniversitar sipas profilit përkatës.

2. Programet orientuese vihen në shërbim të kandidatëve nga njësitë arsimore vendore.

3. Programet publikohen në faqen zyrtare elektronike të IZHA-s, si dhe në portalin e mësuesve.

4. Programi orientues për arsimin parashkollor bazohet në të gjitha programet mësimore të arsimit parashkollor.

5. Programi orientues për arsimin fillor bazohet në të gjitha programet lëndore të arsimit fillor.

6. Programet orientuese për të gjitha profilet bazohen në programet lëndore përkatëse.

7. Programet orientuese për kandidatët e profileve artistike bazohen në programet mësimore për degët e muzikës, artit pamor dhe baletit.

8. Programet orientuese për kandidatët e shkollave speciale përgatiten sipas programeve të formimit të përgjithshëm të përgatitur nga IZHA.

Neni 16

Llojet e testimit të informatizuar

a. Testimet e shpallura për kandidatët janë:

b. Testim i arsimit parashkollor;

c. Testim i arsimit fillor;

Testim për profilet: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjuhë frënge, Gjuhë italiane, Gjuhë gjermane, Matematikë, Fizikë, Biologji, Kimi, Histori, Gjeografi, Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK), Shkenca shoqërore, Ekonomi, Edukim fizik, Muzikë, Art pamor, si dhe profile të tjera specifike brenda planit arsimor, sipas kërkesave nga njësitë arsimore vendore;

d. Testim për degët: Muzikë, Art pamor dhe Balet në kulturën profesionale në shkollat artistike;

e. Testim i përgjithshëm për mësuesit e kulturës profesionale në arsimin special.

Neni 17

Publikimi i rregullave mbi organizimin e testimit

Programet orientuese dhe rregullat mbi mënyrën e organizimit të testimit publikohen në faqen zyrtare të MASR-së dhe IZHA-s në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Neni 18

Hartimi i fondit të pyetjeve

1. Për hartimin e fondit të pyetjeve për zhvillimin e testimit të informatizuar për kandidatët për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar ngrihen nga IZHA grupe pune, sipas profileve të testimit të informatizuar me përfaqësues mësues dhe specialistë të sistemit të arsimit parauniversitar.

2. Hartuesit e fondit të pyetjeve hartojnë fondin e pyetjeve në bazë të standardeve të përcaktuara nga QSHA-ja dhe bëjnë grupimin e tyre, si më poshtë:

i) Në pjesë/module sipas grupimeve kryesore të profileve.

ii) Nivele vështirësie: Niveli 1: i lehtë, Niveli 2: mesatar dhe Niveli 3: i vështirë, duke u konvertuar respektivisht në 1 pikë, 2 pikë dhe 3 pikë të tezës.



3. Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre dhe për zbatimin e ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005, “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, të ndryshuar.

4. Grupet e hartuesve dorëzojnë fondin e pyetjeve për testimin e informatizuar në IZHA, i cili miraton fondin e pyetjeve dhe raportin e disiplinave sipas programeve orientuese.

Neni 19

Miratimi i fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, në lidhje me fondin e pyetjeve për çdo profil, ndjek procedurat e mëposhtme:

a) Merr në dorëzim me procesverbal nga hartuesit fondet e pyetjeve të testimit të informatizuar dhe i miraton ato.

b) Shqyrton fondin e pyetjeve me synimin për përfaqësimin sa më të mirë të njohurive të programit, duke konsideruar:

i) peshën e secilës pjesë të programit që do të përfaqësohet në test dhe përputhshmërinë e pyetjeve me programin orientues të shpallur, si dhe formulimin e saktë të tyre nga ana e përmbajtjes. Kur konstatohet se nuk përmbushen këto kushte, ndryshon formulimin e pyetjes, duke e bërë atë të vlefshme për fondin e pyetjeve ose e heq atë;

ii) përcaktimin e vështirësisë së pyetjeve duke bërë ndryshime, nëse e sheh të arsyeshme;

iii) përgjigjet për saktësinë e fondit të pyetjeve dhe përgjigjeve respektive të çdo profili.

c) Përcakton raportin në përqindje të përfshirjes së pyetjeve të ndara sipas nivelit të vështirësisë në përputhje me karakteristikat e programit të informatizuar të QSHA-së.

d) I dorëzon QSHA-së fondin e miratuar të pyetjeve me alternativat përkatëse, ku saktësohet përgjigjja e saktë, dhe programin orientues.

Neni 20

Mbarëvajtja e zhvillimit të testimit të informatizuar

1. Në ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar duhet të jenë të pranishëm 1-2 përfaqësues nga MASR-ja.

2. Përfaqësuesit asistojnë në prodhimin elektronik të tezës së testimit të informatizuar dhe mbajnë procesverbal për saktësinë e procedurës së ndjekur dhe pyetjeve të përzgjedhura nga sistemi.

3. Përfaqësuesit ndjekin procedurat dhe zhvillimin e testimit të informatizuar në QSHA deri në përfundimin e testimit dhe nënshkruajnë procesverbalin me rezultatet e testimit.

Neni 21

Modalitetet e zhvillimit të testimit të informatizuar

1. Për çdo seancë testi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë automatike janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testimin e informatizuar.

2. Testimi i informatizuar zgjat 60 minuta dhe zhvillohet në një raund të vetëm. Ai fillon dhe mbaron njëkohësisht për të gjithë kandidatët pjesëmarrës në testim, në ditën dhe orarin e caktuar.

3. Vlerësimi i kandidatëve kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik në çastin e përfundimit të testimit. Rezultati përfundimtar i shfaqet kandidatit në monitor dhe printohet në mënyrë automatike nga sistemi së bashku me përgjigjet e dhëna. Çdo kandidat nënshkruan fletën me rezultatet e testimit të printuar në përfundim të testimit përkatës.

4. QSHA-ja ka të drejtë që, në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit, t'u propozojë përfaqësuesve të MASR-së përjashtimin e kandidatit që thyen rregullat. QSHA-ja mban procesverbal, ku evidenton shkeljet e konstatuara.

5. Nëse konstatohet se testimi nuk është zhvilluar sipas rregullave, testimi për kandidatët e asaj sale do të vlerësohet si jo i kryer. Vendimi në këtë rast është në kompetencë të QSHA-së dhe të përfaqësuesve të MASR-së.

Neni 22

Konflikti i interesit

1. Hartuesit e fondit të pyetjeve nuk duhet të jenë autorë të teksteve dhe të librave ndihmës për nxënësit (përveç atyre që botohen nga institucionet e varësisë qendrore të MASR-së).



2. Hartuesit e fondit të pyetjeve dhe personat e autorizuar nga MASR-ja nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatët (bashkëshort /bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit /bashkëshortes).

3. Hartuesit e fondit të pyetjeve dhe personat e autorizuar nga MASR-ja nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit në institucionet përkatëse.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Ruajtja e rezultatit të testimit të mëparshëm

Në rast se kandidatët që aplikojnë për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dëshirojnë të mbartin pikët e testeve të viteve të kaluara, ata nuk do t'i nënshtrohen testimit të informatizuar që zhvillohet në QSHA. Pikët që kanë grumbulluar nga testimet e viteve të kaluara, me kërkesë të kandidatëve, dërgohen nga njësi arsimore vendore në MASR dhe do të shërbejnë për renditjen përfundimtare që do të bëjë Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar.

Neni 24

Ruajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në institucionet përkatëse në përputhje me ligjin “Për arkivat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 25

Mbulimi i shpenzimeve

Shpenzimet për realizimin e testimit të kandidatëve që aplikojnë për t'u punësuar në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar përballohen nga buxheti i institucioneve respektive që përfshihen në këtë proces, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 26

Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 40, datë 9.10.2015, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për organizimin e testimit të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar”, shfuqizohet.

Neni 27

Zbatimi i udhëzimit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MASR, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla



Tabela e konvertimit të lerësimit të testimit të informatizuar

Pikë në sistemin me 100 %	Pikë korresponduese në sistemin me 70 pikë
1	0.7
2	1.4
3	2.1
4	2.8
5	3.5
6	4.2
7	4.9
8	5.6
9	6.3
10	7
11	7.7
12	8.4
13	9.1
14	9.8
15	10.5
16	11.2
17	11.9
18	12.6
19	13.3
20	14
21	14.7
22	15.4
23	16.1
24	16.8
25	17.5
26	18.2
27	18.9
28	19.6
29	20.3
30	21
31	21.7
32	22.4
33	23.1
34	23.8
35	24.5
36	25.2
37	25.9
38	26.6
39	27.3
40	28
41	28.7
42	29.4
43	30.1
44	30.8
45	31.5
46	32.2
47	32.9
48	33.6
49	34.3
50	35
51	35.7
52	36.4
53	37.1



54	37.8
55	38.5
56	39.2
57	39.9
58	40.6
59	41.3
60	42
61	42.7
62	43.4
63	44.1
64	44.8
65	45.5
66	46.2
67	46.9
68	47.6
69	48.3
70	49
71	49.7
72	50.4
73	51.1
74	51.8
75	52.5
76	53.2
77	53.9
78	54.6
79	55.3
80	56
81	56.7
82	57.4
83	58.1
84	58.8
85	59.5
86	60.2
87	60.9
88	61.6
89	62.3
90	63
91	63.7
92	64.4
93	65.1
94	65.8
95	66.5
96	67.2
97	67.9
98	68.6
99	69.3
100	70

**UDHËZIM****Nr. 13, datë 8.3.2018****PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË,
VITI SHKOLLOR 2017-2018**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 26.4.2017, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.2.2013, “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2017-2018, do të zhvillohen si më poshtë:

- a) Lënda Gjuhë e huaj, më 11 qershor 2018.
- b) Lënda Gjuhë shqipe, më 18 qershor 2018.
- c) Lënda Matematikë, më 22 qershor 2018.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare do të zhvillohet më 15 qershor 2018.

3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës/ve të huaj/a hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

4. Nxënësit e klasave IX parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze janë të lirë të zgjedhin midis gjuhës së huaj të parë, që kanë filluar në klasën III, dhe gjuhës së huaj të seksionit përkatës, të filluar në klasën VI.

5. Testi i gjuhës së huaj për nxënësit e klasave IX parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze të hartohet dhe të korrigjohet në bashkëpunim me mësuesit e huaj dhe shqiptarë të këtyre seksioneve.

6. Provimet kombëtare të arsimit bazë fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

7. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për “Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017-2018”.

8. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Në ditën e provimit, Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë tërheqin tezën në DAR Gjirokastrë.

9. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.

10. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

11. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë, “Ramazan Kabashi”, drejtorja e institutit tërheq testin nga QSHA-ja një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *brail*.

12. Nxënësi mbetet në provimet kombëtare të arsimit bazë ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.

13. Inspektorati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.

14. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR /ZA-ve, në Qendrat e Vlerësimit të Testeve.

15. Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës i DAR/ZA-së merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, ISHA dhe MASR.

16. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyra Arsimore dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla**

**UDHËZIM****Nr. 14, datë 26.3.2018****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E MASR-SË NR. 10,
DATË 23.2.2018, “PËR DATAT DHE
ORGANIZIMIN E PROVIMEVE
TË MATURËS SHTETËRORE 2018”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkronjës “a”, të pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 23.2.2018, “Për datat dhe organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2018”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 të udhëzimit shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Teori profesionale e integruar dhe provimi me zgjedhje, 20 qershor 2018.”.

2. Pikat 4.2, 4.3 dhe 4.5, të pikës 4 të udhëzimit “Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2018”, ndryshohen me këto përmbajtje:

“4.2. Provimet e detyruara zgjasin 2 orë e 30 minuta, me përjashtim të provimit të detyruar të Teorisë profesionale të integruar, që zgjat 1 orë e 30 minuta.

4.3 Provimet me zgjedhje zgjasin 3 orë. Provimi me zgjedhje për shkollat e mesme profesionale zgjat 1 orë e 30 minuta.

4.5 Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

Testet e Teorisë profesionale të integruar përmbajnë secili nga 20 pyetje, nga të cilat 10 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me nga 1 pikë secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje të tjera të llojeve të ndryshme, të cilat vlerësohen me 30 pikë gjithsej. Testi i Teorisë profesionale të integruar vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1394, datë 16.2.2018, vendosi shpalljen të vdekur të shtetases Lumturi Boka, e datëlindjes 13.4.1963, në datën 10.6.1985, si dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të saj, shtetasin Zyhdë Boka.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë